

Marrëveshje Bashkëpunimi

Gjatë vitit 2023, Qendra Kombëtare e Biznesit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me:

- Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, me synim angazhimin e përbashkët për t'ju ardhur në ndihmë subjekteve të reja për informimin mbi rregulloret dhe legjislacionin e punës në fuqi dhe rritjen e ndërgjegjësimit të bizneseve, mbi të drejtat dhe detyrimet ligjore që kanë për rritjen e standarteve dhe sigurinë në punë që lindin nga momenti i regjistrimit fillestar si biznes pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- Bordin e Mbikëqyrjes Publike, me qëllim forcimin e monitorimit dhe kontrollit të subjekteve në fushën e aktivitetit “Auditues Ligjor”, “Kontabilist i Miratuar” si dhe të profesioneve të tjera, të cilat bien ndesh me profesionin e kontabilistit të miratuar dhe audituesit Ligjor dhe gjithashtu rrit mbikëqyrjen dhe transparencën në sektorin e auditimit ligjor dhe raportimit financiar. Marrëveshja synon forcimin e mbikëqyrjes në lidhje me subjektet e regjistruara pranë QKB-së, të cilët kanë depozituar informacionin vjetor në përputhje me legjislacionin mbi audituesin ligjor, raportin e auditimit, pasqyrat financiare dhe hartuesin e pasqyrave financiare duke kontrolluar subjektet certifikuese të tyre dhe marrjen e masave të drejtëpërdrejta ndaj shkeljeve të konstatuara.